

KËSHILLI I MINISTRAVE

RAPORT

PËR

KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

MBI ECURINË E PROCESIT TË INTEGRIMIT

PËR VITIN 2016

PËRMBAJTJA

| | |
|--|-----------|
| HYRJE | 4 |
| 1. PLANI KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN 2016 -2020..... | 5 |
| 2. PROGRESI PËR PESË PRIORITETET E REKOMANDUARA NGA KOMISIONI EVROPIAN | 6 |
| 3. RAPORTI I KOMISIONIT EVROPIAN PËR SHQIPËRINË 2016 | 8 |
| 4.PËRGATITJA PËR NEGOCIATAT E ANËTARËSIMIT | 9 |
| 5. ECURIA E ZBATIMIT TË MSA-SË | 10 |
| 6. BASHKËPUNIMI ME BASHKIMIN EVROPIAN | 20 |
| 7. PROGRAMIMI DHE MONITORIMI I FONDEVE IPA PËR VITET 2014, 2015 DHE 2016..... | 22 |
| 8. BASHKËPUNIMI TERRITORIAL | 30 |
| 9. FORCIMI I KAPACITETEVE NË PROCESIN E INTEGRIMIT | 33 |
| 10. PËRFUNDIME..... | 34 |

Lista e shkurtimeve

| | |
|--------|--|
| ASPA | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike |
| BE | Bashkimi Evropian |
| DAP | Departamenti i Administratës Publike |
| DBE | Delegacioni i Bashkimit Evropian |
| GNP | Grup ndërinstitucional i punës |
| IPA | Instrumenti i Asistencës së Paraanëtarësimit |
| KE | Komisioni Evropian |
| KKIPA | Koordinatori Kombëtar i Instrumentit të Paraaderimit |
| MSA | Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit |
| PKIE | Plani Kombëtar i Integritit Evropian |
| SBS | Mbështetje Buxhetore Sektoriale |
| SEETO | Observatori i Transportit për Europën Juglindore |
| SPD | Dokumentit të Planifikimit Sektorial |
| SIMBNJ | Sistemi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore |
| SKZHI | Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim |
| SMEI | Projekti i asistencës teknike të Bashkimit Evropian “Mbështetje për procesin e integritit” |

Hyrje

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian (BE) mbetet një nga pikësynimet strategjike të qeverisë shqiptare dhe gjithashtu objektivi kombëtar i Republikës së Shqipërisë. Në datën 9 nëntor 2016, Komisioni Evropian publikoi Raportin vjetor për Shqipërinë, në të cilin evidentoi përparimin e bërë nga qeveria shqiptare në plotësimin e pesë prioritetëve kyçe për hapjen e negociatave për anëtarësim. Komisioni i rekomandoi Këshillit Evropian çeljen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë, duke vendosur si kusht nisjen e zbatimit efektiv të reformës në drejtësi dhe veçanërisht rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve (procesi i vetting-ut).

Pas rekomandimit të Komisionit Evropian për hapjen e negociatave me Shqipërinë, konkluzionet e takimit të Ministrave të Punëve të Jashtme të vendeve anëtare të BE, të hartuara nga Presidenca sllovaqe e Këshillit më datë 13 dhjetor 2016, shënuan një tjetër arritje drejt hapjes së negociatave të anëtarësimit. Vendet anëtare të BE njohën progresin e qendrueshëm të Shqipërisë në përmbushjen e pesë prioritetëve kyçe për hapjen e negociatave dhe e inkurajuan Shqipërinë për të vijuar më tej drejt rrugës së progresit dhe për të konsoliduar edhe më shumë arritjet. Vendet anëtare reagueshan pozitivisht ndaj rekomandimit të Komisionit për hapjen e negociatave dhe u angazhuan që t'i kthehen kësaj çështje, sapo Shqipëria të ketë arritur progres të mjaftueshëm për zbatimin e reformës në drejtësi. Qeveria shqiptare ka nisur në këtë drejtim përgatitjet për organizimin dhe forcimin e strukturave të administratës publike për hapjen e procesit të negociatave.

Për më tepër, vendet e BE-së i kërkojnë Shqipërisë dhe Komisionit që të përgatiten për hapjen e negociatave, duke ftuar Komisionin Evropian që të ‘mbështesë zbatimin e reformës në drejtësi dhe të intensifikojë angazhimin teknik me Shqipërinë’. Këshilli kërkon vazhdimin e përpjekjeve të Shqipërisë në luftën kundër krimit të organizuar e korrupsionit, duke vlerësuar qartë arritjet e deritanishme me konstatimin e ‘tendencës pozitive në ndërtimin e një historiku arritjesh në hetime, ndjekje dhe dënime, në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar’.

Sikurse gjatë vitit 2015, edhe gjatë vitit 2016, qeveria shqiptare ka vijuar të përmbushë me angazhim të lartë masat e parashikuara në Udhërrëfyes për pesë prioritetet e rekomanduara nga Komisioni Evropian në vitin 2013. Po ashtu, gjatë vitit 2016, në zbatim të angazhimeve të ndërmarra përmes nënshkrimit dhe ratifikimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) me BE dhe Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2016-2020, qeveria shqiptare ka forcuar realizimin e masave të parashikuara në kuadër të përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis communautaire*.

Raporti në vijim është hartuar nga Këshilli i Ministrave në zbatim të detyrimeve të nenit 18, pika 1 e ligjit nr.15/2015, datë 5.3.2015, “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”. Ky dokument përfshin përmbledhje të detajuar të ecurisë së bisedimeve për çeljen e negociatave dhe anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian për vitin 2016. Raporti përmban informacion mbi disa çështje kyçe të këtij procesi, sikurse janë përmbushja e MSA-së, Plani Kombëtar i Integritit Evropian (PKIE) 2016-2020, Udhërrëfyesi për 5 prioritetet, menaxhimi i fondeve nga Bashkimi Evropian si dhe forcimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore.

1. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2016 -2020

Hartimi i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2016 – 2020, i filluar në tremujorin e fundit të vitit 2015, u finalizua gjatë muajit janar 2016. Gjatë muajit janar të vitit 2016, Ministria e Integritit Europian kontrollon po ashtu, përputhshmërinë mes Projektplanit Kombëtar për Integrimin Evropian 2016-2020 dhe programeve analitike të projektakteve të paraqitura nga ministrinë e linjës për të garantuar përputhshmërinë e plotë mes këtyre dy dokumenteve të qeverisë shqiptare.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2016 – 2020 u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 74, datë 27.1.2016. Zbatimi i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2016 – 2020 u monitorua në mënyrë të vazhdueshme nga Ministria e Integritit Europian, e cila përgatiti tre raporte monitorimi për PKIE 2016 – 2020, si më poshtë:

- Prill 2016, për 3-mujorin e parë të vitit 2016;
- Korrik 2016, për 6-mujorin e parë të vitit 2016;
- Tetor 2016, për 9-mujorin e vitit 2016.

Raporti i përfundimtar i cili reflekton gjithë procesin e zbatimit të Planit Kombëtar të Integritit Europian 2016-2020, u përgatit në janar 2017.

Për një monitorim sa më të mirë dhe për të nxitur zbatimin e Planit, Ministria e Integritit Europian, filloi në muajin shtator 2016 monitorimin javor të zbatimit të PKIE-së. Monitorimi i zbatimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2016 – 2020, tregoi se nga 236 akte të parashikuara (masa ligjore që synojnë përafrimin dhe dokumente strategjike) u miratuan në total 133 akte të tilla, ose 56.4%. Masa e zbatimit të PKIE për vitet 2015 dhe 2016 dëshmon nevojën për të përmirësuar metodologjinë e hartimit të PKIE, përkatësisht nevojën për planifikim realist dhe të argumentuar qartë për secilin nga aktet e parashikuara në të. Kjo çështje metodologjike është adresuar gjatë hartimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2017 – 2020. Planifikimi i përafrimit me legjislacionin e BE është një proces kompleks, i cili pashmangshmërisht kërkon përmirësime metodologjike me çdo PKIE të re. Raportet e monitorimit të PKIE janë publikuar rregullisht në faqen zyrtare të Ministrisë së Integritit Europian: <http://www.integrimi.gov.al/al/dokumente/raporte>.

Në tetor 2016, Ministria e Integritit Europian inicioi hartimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2017 – 2020. Ministria e Integritit Europian udhëzoi paraprakisht ministrinë e linjës mbi procedurat dhe formatin e PKIE 2017 – 2020. Në PKIE 2017 – 2020 u pasqyruan edhe rekomandimet e Raportit të Komisionit për Shqipërinë për vitin 2016 dhe rekomandimet e takimeve të institucioneve të përbashkëta Shqipëri – Bashkimi Evropian ngritur në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Në kuadër të programit të transparencës bazuar në Ligjin Nr. 119/2014, datë 18.9.2014 “Për të drejtën e informimit” si dhe detyrimin për konsultim publik të dokumenteve strategjike bazuar në Ligjin Nr. 146/2014, datë 30.10.2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, Ministria e Integritimit European realizoi konsultimin e masave të parashikuara në PKIE 2017 – 2020 me organizatat e shoqërisë civile (OSHC) dhe grupet e interesit.

Drafti i PKIE-së 2017 – 2020, iu dërgua për konsultim nëpërmjet një platforme elektronike javën e dytë të muajit nëntor 2016, rreth 700 organizatave të shoqërisë civile. Afati i paraqitjes së komenteve dhe sugjerimeve ishte data 10 dhjetor 2016. Paralelisht, nga data 25 nëntor deri në 14 dhjetor 2016, u zhvilluan në ambientet e Ministrisë së Integritimit European, 10 takime konsultative, në bashkëpunim me përfaqësues nga ministritë e linjës (kryesisht kryetarët e GNPIE-së për kapitullin) dhe institucioneve, me grupet e interesit dhe përfaqësues nga OSHC-të sipas fushave të PKIE-së, si energjia, lëvizja e lirë e mallrave, shoqëria e informacionit, bujqësia dhe peshkimi, transporti, çështjet financiare, politikat sociale, gjyqësori, shkenca dhe mjedisi. Komentet e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit mbi kapituj të veçantë të PKIE 2017 – 2020 u vlerësuan nga përfaqësuesit e ministrive të linjës dhe institucioneve për përshtatshmërinë e tyre me projekt PKIE 2017 – 2020. PKIE 2017 – 2020 u miratua në Këshillin e Ministrave, më 25 janar 2017.

2. Progresi për pesë prioritetet e rekomanduara nga Komisioni Evropian

Gjatë vitit 2016, Ministria e Integritimit European koordinoi takimin e Dialogut të Nivelit të Lartë, i cili u zhvillua në Tiranë me datë 30 mars 2016. Takimi u bashkëdrejtua nga Z. Edi Rama, Kryeministër i Shqipërisë dhe Z. Johannes Hahn, Komisioneri për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit të Bashkimit Evropian. Takimi i Dialogut të Nivelit të Lartë analizoi arritjet e reformave që ndikojnë drejtpërdrejtë në përmbushjen e pesë prioritetëve për hapjen e negociatave të anëtarësimit. Qeveria shqiptare konfirmoi angazhimin për një reformë të thellë në sistemin e drejtësisë si një reformë kyçe, që do të krijojë kushtet për të çelur negociatat, por më e rëndësishmja që do të krijojë kushtet për ndërtimin dhe funksionimin e një sistemi drejtësie të denjë për një vend që aspirojnë një ditë të bëhet anëtar i Bashkimit Evropian. Qeveria shqiptare ftoi opozitën për zhvillimin e një dialogu politik në nivel të lartë për të diskutuar mbi këtë reformë kaq të rëndësishme për të ardhmen e Shqipërisë.

Komisioneri për Zgjerimin, Z. Johannes Hahn, vlerësoi takimin dhe dialogun me Qeverinë dhe opozitën. Ai theksoi se “duhet të jetë e qartë që e ardhmja evropiane e Shqipërisë duhet të jetë interesi kombëtar i këtij vendi”. Takimi i Nivelit të Lartë theksoi rëndësinë e marrjes sa më shpejt dhe pa ndërlikime të panevojshme të vendimit mbi reformën në drejtësi. Gjithashtu u theksua edhe nevoja për të avancuar më tej lidhur me dekriminalizimin dhe reformën zgjedhore. Në tërësi, takimi konfirmoi angazhimin e dyanshëm të Qeverisë shqiptare dhe të Komisionit Evropian për progresin e bërë drejt hapjes së negociatave.

Ministria e Integritit European vijoi koordinimin e punës me institucionet përgjegjëse për 5 prioritetet për të ndjekur progresin e bërë si dhe për përgatitjen e raportimeve tremujore të zbatimit të masave të Udhërrëfyesit të 5 prioriteteve kyçe. Raportimet tremujore të përgatitura të cilat reflektonin progresin për masat e parashikuara në Udhërrëfyes iu dërguan periodikisht Komisionit Evropian.

Gjithashtu, Ministria e Integritit European koordinoi dhe monitoroi zbatimin e “Planit të Masave për Rekomandimet Afatshkurtra”, një dokument i brendshëm pune i hartuar mbi bazën e rekomandimeve të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2015. Ky dokument u monitorua periodikisht, çdo dy javë, dhe për të iu raportua Bordit të Integritit Evropian, i ngritur me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 154, datë 23.11.2015 “Për Ngritjen e Bordit të Integritit Evropian”. Masat e planit u zbatuan rregullisht sipas kohës së planifikuar.

Gjatë vitit 2016, Ministria e Integritit European koordinoi dhe bashkërendoi punën me institucionet përgjegjëse për realizimin e katër misionëve të ekspertëve të Komisionit Evropian:

- Misioni mbi luftën ndaj korrupsionit, zhvilluar në Tiranë, në datat 15 – 19 shkurt 2016. Ky mision kishte për qëllim vlerësimin e progresit të Shqipërisë në luftën ndaj korrupsionit dhe krimeve financiare, me një fokus të veçantë në hetimet financiare, kapacitetet e inspektimeve financiare, konfiskimin e aseteve, pastrimin e parave, dhe kryesisht në rastet ku janë përfshirë zyrtarët e lartë.
- Misioni mbi luftën kundër krimit të organizuar, zhvilluar në Tiranë, në datat 6 – 9 qershor 2016, pati për qëllim punën e bërë në këtë fushë dhe masat e marra nga MPB dhe strukturat e saj për luftën ndaj krimit të organizuar në Shqipëri.
- Në datat 23-27 maj 2016, u zhvillua në Tiranë misioni i vlerësimit “Mbi sistemin gjyqësor, me referencë të veçantë ndaj efijencës dhe profesionalizmit”. Ky mision vlerësimi kishte në fokusin e tij, monitorimin e mënyrës së funksionimit të sistemit gjyqësor, problematikat e çështjeve të mbartura, numrit të gjyqtarëve dhe vendet vakante të krijuara në shkallë të ndryshme të gjykimit, përzgjedhjen dhe shpërndarjen e çështjeve bazuar në sistemin e hedhjes së shortit, si dhe efijenca e përdorimit të sistemit të regjistrimit audio, gjatë zhvillimit të proceseve gjyqësore.
- Misioni i katërt, ai i ekspertëve të Komisionit Evropian për Lirinë e Shprehjes u organizua nga TAIEX në Tiranë, në datat 18 - 22 prill 2016. Ky mision kishte për qëllim vlerësimin e progresit të Shqipërisë mbi lirinë e shprehjes, fokusimi në aspektet ligjore dhe organizmat shtrëngues për monitorimin e respektimit të lirisë së shprehjes. Një vëmendje e veçantë iu kushtua ligjit të ri për median, si dhe zbatueshmërisë së ligjit për të drejtën e autorit.

Rekomandimet e misionëve të sipërpërmendura ju janë përcjellë institucioneve përgjegjëse dhe vijon puna për vënien në zbatim të masave në përputhshmëri me rekomandimet.

3. Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2016

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Ministria e Integritimit Evropian koordinoi hartimin e dy kontributeve të qeverisë shqiptare për Raportin e Komisionit Evropian për vitin 2016. Këto dy kontribute iu paraqitën shërbimeve të Komisionit Evropian përkatësisht në datat 23 maj 2016 dhe 1 shtator 2016.

Në përputhje me kërkesat e shërbimeve të Komisionit Evropian, kapitujt të caktuar të këtyre raportimeve u hartuan bazuar në një metodologji të re e cila mundëson një vlerësim të njëkohshëm dhe më të mirë të situatës aktuale në procesin e anëtarësimit dhe të përparimit të bërë gjatë periudhës së raportimit. Njëkohësisht, kjo metodologji e re mundëson edhe krahasimin më të mirë të situatës ndërmjet vendeve kandidate apo kandidate potenciale. Ministria e Integritimit Evropian organizoi trajnime të veçanta për ministrinë të cilat do të raportonin sipas metodologjisë së re si dhe i udhëzoi në mënyrë të vazhdueshme gjatë këtij procesi.

Në datën 9 nëntor 2016, Komisioni Evropian publikoi Raportin vjetor për Shqipërinë si dhe Politikën e Zgjerimit të Bashkimit Evropian për vitin 2016. Në Politikën e Zgjerimit të Bashkimit Evropian për vitin 2016, Komisioni Evropian konkludoi se “Duke pasur parasysh përparimin e mësipërm në plotësimin e prioritete kyçe dhe në varësi të përparimit të besueshëm dhe të prekshëm në zbatimin e reformës në drejtësi, veçanërisht në rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve (vetingu), Komisioni rekomandon hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë”.

Vendet anëtare reagojnë pozitivisht ndaj rekomandimit të Komisionit për hapjen e negociatave, në varësi të zbatimit të reformës së sistemit të drejtësisë, me fokus zbatimin e ligjit për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Vendet e BE-së u angazhuan që t’i kthehen kësaj çështjeje sapo Shqipëria të ketë arritur progres të mjaftueshëm në këtë drejtim. Për këtë, ato e ftuan Komisionin që t’u raportojë në momentin kur ky progres të jetë arritur. Pra hapat e caktuara nga vendet anëtare për hapjen zyrtare të negociatave janë shumë të qartë: pasi Shqipëria të ketë ecur në zbatimin e procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Komisioni do të informojë vendet anëtare, në mënyrë që këta të fundit të marrin vendimin zyrtar për hapjen e negociatave.

Ministria e Integritimit Evropian analizoi në tërësi Raportin e Komisionit dhe dokumentin e Politikës së Zgjerimit duke identifikuar përparimin e arritur dhe rekomandimet për të ardhmen për çdo kapitull negociues. Kjo analizë iu dërgua të gjitha ministrive dhe institucioneve të tjera dhe u përdor si dokument referencë gjatë hartimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2017 – 2020, hartimit të planeve të punës të ministrive dhe institucioneve përgjegjëse apo hartimit në vijim të dokumenteve strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale.

Një raportim i plotë mbi gjetjet e rekomandimet e Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë 2016 dhe angazhimet për përmbushjen e tyre, kjo edhe në respektim të kërkesave të

Ligjit Nr. 15/2015, datë 5.3.2015, “Për Rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, iu paraqit Kuvendit të Shqipërisë nga Këshilli i Ministrave në 19 dhjetor 2016.

Më datë 1 dhjetor 2016, Ministria e Integrimit Evropian organizoi takimin konsultativ me organizatat e shoqërisë civile lidhur me rekomandimet e Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2016, ku morën pjesë rreth 40 organizata të shoqërisë civile. Qëllimi i tij ishte njohja e OSHC-ve me rekomandimet e Raportit të KE-së, mënyra se si këto organizata lexojnë detyrimet që dikton raporti, përkatësisht sipas fushave të tyre të veprimit.

4. Përgatitja për negociatat e anëtarësimit

Sikurse është përcaktuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015 – 2020, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 348, datë 11.5.2016 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020”, qeveria shqiptare mbetet e angazhuar të demonstrojë deri në vitin 2020 përpara partnerëve të saj në BE, se institucionet dhe shoqëria e saj kanë përparuar mjaftueshëm në rrugën e përfundimit me sukses të negociatave që Shqipëria të bëhet një anëtar i plotë i Bashkimit Evropian.

Për këtë qëllim, Ministria e Integrimit Evropian gjatë vitit 2016 punoi për hartimin dhe konceptimin e një projektdokumenti mbi strukturat negociuese të administratës publike. Dokumenti përshkruan organet që planifikohen të ngrihen për koordinimin dhe monitorimin e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, si dhe propozon masa për forcimin e kapaciteteve administrative për zhvillimin e negociatave. Dokumenti u hartua duke pasur parasysh përvojën më të mirë rajonale në zhvillimin e negociatave.

Në mbështetje të hartimit të projektdokumentit konceptual, për njohjen e eksperiencës rajonale për negociatat e anëtarësimit, përfaqësues të Ministrisë së Integrimit Evropian zhvilluan takime me Kryenegociatorin e Malit të Zi në negociatat e anëtarësimit në Bashkimin Evropian me datë 22 janar 2016. Takimet u përqendruan në ngritjen dhe funksionimin e strukturave negociuese, kostot e procesit të negociatave, etj.

Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi, në kontekstin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 537, datë 18.6.2015, me datë 15 mars 2016, në Podgoricë, u zhvillua takimi i parë i Komitetit të Përbashkët për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Takimi i parë u përshëndet nga Ministri i Integrimit Evropian të Shqipërisë, dhe Sekretari i Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të Integrimit të Malit të Zi dhe Kryenegociatori i Malit të Zi në negociatat e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Në këtë takim, përfaqësuesit e të dy vendeve shkëmbyen informacione dhe mendime mbi hartimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, strukturat negociuese, procesin e negociatave, programimin dhe monitorimin e IPA-s.

Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe përgatitjes së Shqipërisë për negociatat e anëtarësimit, Ministrja e Integritimit Evropian, Znj. Klajda Gjoshja zhvilloi me datë 21 nëntor 2016, në Tiranë, një takim pune me Znj. Tanja Mišćević, Kryenegociatore e Serbisë dhe Z. Aleksandar Andrija Pejović, Kryenegociator i Malit të Zi. Në takim u diskutua mbi rëndësinë e procesit të integritimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian dhe rolin tejet të rëndësishëm që ka gjithëpërfshirja e aktorëve. Kryenegociatorët e Serbisë dhe Malit të Zi shprehën gatishmërinë për të mbështetur Shqipërinë në nivel teknik, si dhe duke ndarë eksperiencën e tyre në procesin e negociatave.

Në vijim të serive të takime konsultative me struktura rajonale, projektdokumenti konceptual, tashmë i përmirësuar, iu paraqit ministrive të linjës, Delegacionit të Bashkimit Evropian dhe Komisionit Evropian me datë 9 shtator 2016. Komentet dhe sugjerimet e marra prej tyre do të gjejnë pasqyrim në dokumentin final.

Projektdokumenti konceptual u diskutua dhe në takimin e Interministerialit të Integritimit Evropian, i cili u mbledh me datë 5 tetor 2016. Në këtë takim u paraqitën elementët kryesorë të dokumentit, strukturat e paraqitura në të dhe ndërveprimi mes tyre. Në takim u vendos që projektdokumenti të punohet dhe detajohet më tej me qëllim parashikimin sa më saktë të strukturave negociuese, roleve dhe kompetencave të secilit prej tyre. Në vijim të takimit të Interministerialit, si pjesë të projektdokumentit konceptual, Ministria e Integritimit Evropian përgatiti edhe një analizë krahasimore të modeleve të ndryshme të strukturave negociuese kombëtare duke u bazuar në modelet e strukturave negociuese të përdorura nga Kroacia, Mali i Zi dhe Serbia.

Në datën 21 nëntor 2016, në ambientet e Kryeministrit, u zhvillua një takim i ngushtë informues me përfaqësuesit e ministrive të linjës në cilësinë e koordinatorëve të caktuar nga ministrat përkatës. Ky takim u realizua për të informuar të ftuarit, mbi strukturën e negociatave, strukturat administrative të parashikuara, kompetencat e tyre bazuar në projektdokumentin konceptual, etj. Vëmendje e veçantë iu kushtua rritjes së ndërgjegjësimit për seriozitetin dhe përkushtimin që kërkon ky proces dhe përgatitjes paraprake që duhet t'i kushtohet.

Së shpejti, në faqen e internetit të Ministrisë së Integritimit Evropian dhe Ministrisë të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, do të shpallet formulari për aplikimin e nëpunësve civilë të interesuar për të qenë pjesë e grupeve të punës në procesin e negociatave.

5. Ecuria e zbatimit të MSA-së

Përafrimi i legjislacionit

Në plotësim të detyrimeve të Nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për përafrimin e *acquis* së BE-së dhe neneve në fusha të tjera të MSA-së, si më poshtë një pasqyrim i arritjeve sipas kapitujve ku ka patur përafrim thelbësor të plotë dhe të pjesshëm të legjislacionit shqiptar.

Në plotësim të detyrimeve të neneve 70 dhe 75 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, për kapitullin 1 “Lëvizja e lirë të mallrave”, janë miratuar një numër aktesh ligjore të rëndësishme si:

- Ligji Nr. 27 datë 17.05.2016 “Mbi menaxhimin e kimikateve”, i cili është përafuar pjesërisht me Rregulloren Nr. 1907/2006 të Këshillit të datës 18 dhjetor 2006 mbi “Regjistrimin, vlerësimin, autorizimin dhe kufizimin e kimikateve”, dhe Rregulloren Nr. 1272/2008 “Mbi klasifikimin, etiketimin, dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve”, si dhe Rregulloren Nr. 649/2012 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 4 korrik 2012 mbi “Eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 189 datë 9.03.2016 “Për miratimin e rregullit teknik për kërkesat thelbësore, markimi në CE dhe vlerësimi i konformitetit të pajisjeve mjekësore diagnostikuese in vitro”, i cili është i përafuar me Direktivën 98/79 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 27 tetorit 1998, “Mbi pajisjet mjekësore diagnostikuese in vitro”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 488, datë 29.06.2016 “Mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e kimikateve” i cili është përafuar pjesërisht me Rregulloren Nr. 1907/2006 të Këshillit të datës 18 dhjetor 2006 mbi “Regjistrimin, vlerësimin, autorizimin dhe kufizimin e kimikateve”, dhe Rregulloren Nr. 1272/2008 “Mbi klasifikimin, etiketimin, dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve”, si dhe Rregulloren Nr. 649/2012 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 4 korrik 2012 mbi “Eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 489 datë 29.06.2016 “Lista e substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC), kriteret për përfshirjen e substancave në listën e SVHC dhe lëshimi i një autorizimi të kushtëzuar me qëllim vazhdimin e përdorimit të SVHC” i cili transponon pjesërisht rregulloret REACH dhe CLP (1907/2006/KE për Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe kufizimet e kimikateve (REACH) dhe krijimin e Agjencisë Evropiane të Kimikateve, 649/2012/KE për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme, 1272/2008/KE për klasifikimin etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve);
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 665, datë 21.09.2016 “Për importin dhe eksportin e kimikateve të rrezikshme”, i cili është plotësisht i përafuar me Rregulloren (KE) nr. 649/2012 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian, të datës 4 korrik 2012, në lidhje me eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme,
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 675, datë 28.09.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për krijimin e sistemit të gjurmimit dhe identifikimit të lëndëve plasëse”, i cili është i përafuar me Direktivën e Komisionit 2008/43/KE “Për ngritjen, sipas direktivës së Këshillit 93/15/KEE, të një sistemi të identifikimit dhe gjurmimit të lëndëve plasëse për përdorim civil” e konsoliduar;
- Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë nr. 415, datë 29.09.2016 “Rishikimi i Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë Nr. 356, datë 10.06.2007 për Politikën kombëtare për menaxhimin e pajisjeve mjekësore.”
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 770, datë 2.11.2016 “Për miratimin e rregullit teknik “Për instrumentet matëse”, për disa ndryshime në vendimin nr. 1351, datë 3.10.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për kërkesat dhe metrologjike për instrumentet matëse, ligjërisht të kontrolluara”, dhe përcaktimin e listës së standardeve të

harmonizuara”, i cili është plotësisht i përafuar me Direktivën Evropiane 2014/32/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 26 shkurt 2014 “Për instrumentet matëse”.

Në plotësim të detyrimeve të neneve të MSA-së 50, 57, 58, 70, 100 për kapitullin 3, “E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime”, janë miratuar këto masa ligjore:

- Ligji Nr. 66/2016 datë 9.06.2016 “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë”, ky ligj është i përafuar pjesërisht me Direktivën 2006/123/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 12 dhjetor 2006, “Për shërbimet në tregun e brendshëm”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 360, datë 11.5.2016 “Për miratimin e rregullave për krijimin dhe administrimin e fondit për shërbimin universal postar dhe mënyrat e përcaktimit të kontributit, në rastin e bashkëfinancimit nga ofruesit e shërbimit universal postar”, i cili është plotësisht i përafuar me Direktivën 97/67/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15 dhjetor 1997 “Për rregullat e përbashkëta për zhvillimin e tregut të brendshëm të shërbimit postar të Komunitetit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit”, e ndryshuar me “Direktivën 2002/39/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 10 qershor 2002, Rregulloren (KE) 1882/2003 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 29 shtator 2003 dhe Direktivën 2008/6/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 20 shkurt 2008;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 11, datë 11.1.2016 “Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, për periudhën 2014–2020.

Në plotësim të detyrimeve të nenit 70-të për kapitullin 6, “E drejta e shoqërive tregtare”, është miratuar Ligji 47/2016, datë 28.04.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, i cili është pjesërisht i përafuar me Direktivën 2006/43/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 17 maj 2006, “Mbi auditimet ligjore të llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara, amendimin e direktivave të Këshillit 78/660/KEE dhe 83/349/KEE dhe shfuqizimin e direktivës së Këshillit 84/253/KEE”, e amenduar, Rregulloren (BE) nr. 537/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 16 prill 2014, “Mbi kërkesat specifike në lidhje me auditimin e njësive me interes publik dhe shfuqizimin e vendimit të Komisionit 2005/909/KE”.

Në zbatim të nenit 73 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe si pjesë e kapitullit 7, “E drejta e pronësisë intelektuale”, u miratua Ligj Nr. 35/2016, datë 31.3.2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të” në përputhshmëri të plotë me:

- Direktivën 2001/29/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 22 majit 2001 mbi “Harmonizimin e disa aspekteve të të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në shoqërinë e informacionit”;
- Direktivën 2001/84 EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 27 shtatorit 2001 mbi “Të drejtën e rishitjes për përfitimin e autorit të një vepre origjinale arti”;

- Direktivën 2006/115 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 12 dhjetorit 2006 mbi “Të drejtën e rishitjes dhe të drejtën e hua-qerasë mbi disa aspekte të caktuara të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në fushën e pronësisë intelektuale”;
- Direktivën 2006/116/ EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 12 dhjetorit 2006 mbi “Kohëzgjatjen e mbrojtjes të së drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të”;
- Direktivën 96/9/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 11 marsit 1996 mbi “Mbrojtjen ligjore të bazës së të dhënave”;
- Direktivën 2009/24 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 23 prill 2009 “Mbi mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike” Direktiva 93/83/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 27 shtatorit 1993 mbi “Koordinimin e rregullave të caktuara lidhur me të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura e zbatueshme për transmetimet satelitore dhe kabllore”;
- Direktivën 93/83/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 27 shtatorit 1993 “Mbi koordinimin e rregullave të caktuara lidhur me të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura e zbatueshme për transmetimet satelitore dhe kabllore”;
- Direktivën 2004/48/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 29 prill 2004 mbi “Zbatimin e të drejtave të Pronësisë Intelektuale”;
- Direktivën 2014/26/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 26 shkurt 2014 “Për menaxhimin kolektiv të të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të dhe licencimi multi-territorial i të drejtave të veprave muzikore për përdorim në internet në tregun e brendshëm.

Gjithashtu, gjatë vitit 2016 u miratua edhe Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Pronësisë Intelektuale, e cila përforcon bashkëpunimin midis aktorëve të përfshirë, përmirëson sistemin e mbrojtjes dhe procedurat e ekzaminimit të objektit të pronësisë intelektuale si dhe lehtësim të procedurave të aplikimeve, thëllon bashkëpunimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve me organizatat ndërkombëtare si WIPO, EPO etj.

Nenet 70, 71 dhe 72 të MSA parashikojnë detyrimet e Republikës së Shqipërisë në zbatim të kapitullit 8 “Politikat e konkurrencës” dhe për këtë qëllim është miratuar:

- Vendim i Komisionit të Konkurrencës nr. 419, datë 8.06.2016 “Për miratimin e Udhëzimit ‘Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve”, i cili është në përputhje me Njoftimin e Komisionit mbi procedurat e thjeshtuara në trajtimin e disa përqendrimeve sipas Rregullores së Këshillit (KE) Nr 139/2004 (52013XC1214(02) (2013/C 366/04);
- Vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr. 437, datë 5.10.2016 “Për miratimin e Rregullores “Mbi procedurat e angazhimeve”, e cila është e përafuar me Rregulloren e Këshillit (KE) Nr 1/2003 e datës 16 dhjetor 2002 mbi implementimin e rregullave të konkurrencës sipas neneve 81 dhe 82 të Traktatit.

Për sa i përket ndihmës shtetërore është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 650, datë 14.9.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, intensitetit dhe të procedurës për dhënien dhe autorizimin e ndihmës shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik dhe publik”, i cili është pjesërisht i përafuar me 2012/21/BE: Vendimi i Komisionit i datës 20 dhjetor 2011 mbi zbatimin e nenit 106(2) të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian për ndihmën shtetërore në formën e kompensimit për shërbimin publik dhënë disa ndërmarrjeve të caktuara të cilave u është besuar kryerja e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik (njoftuar me dokumentin C(2011) 9380).

Për kapitullin 9 “Shërbimet financiare” dhe në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga nenet 50, 57, 70, 82 dhe 89 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit është miratuar:

- Ligji nr. 36/2016, datë 31.03.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009, ‘Për sipërmarrjet e investimeve kolektive’”. Ky ligj është përafuar pjesërisht me Direktivën 2009/65/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 13 Korrikut 2009 “Për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative lidhur me sipërmarrjet për investimet kolektive në letrat me vlerë të transferueshme (UCITS)”;
- Ligji nr. 52/2016, datë 19.05.2016 “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, i cili është i përafuar pjesërisht me Direktivën 2013/36/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 26 qershor 2013 “Mbi veprimtarinë e institucioneve të kreditimit dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve të kreditimit dhe shoqërive të investimit” që ndryshon Direktivën 2002/87/KE dhe shfuqizon direktivat 2006/48/KE dhe 2006/49/KE;
- Rregullore nr. 1, datë 25.01.2016 “Për procedurat dhe mënyrën e depozitimit të informacionit dhe dokumentacionit në lidhje me burimin e kapitalit për aksionarët e shoqërisë së sigurimit” dhe Rregullore nr. 9, datë 25.01.2016 “Mbi bazat dhe metodat e llogaritjes, mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike, si dhe kriteret dhe procedurat e miratimit të tyre nga Autoriteti” dhe Rregullore nr. 76, datë 30.05.2016 “Mbi kategoritë e investimeve të lejuara, kufizimet që zbatohen dhe përdorimin e instrumenteve financiare derivateve” të cilat përafrojnë pjesërisht Direktivën e Këshillit 92/49/KEE, datë 18 Qershor 1992, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimet e drejtpërdrejta me përjashtim të sigurimit të jetës, dhe për ndryshimin e Direktivës 73/239/KEE dhe Direktivës 88/357/KEE (Direktiva e tretë për sigurimet jo- jetë);
- Rregullore nr. 2, datë 25.01.2016 “Për formën, afatet dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, raporteve statistikore dhe raportimeve të tjera të ndërmjetësve në sigurime dhe risigurime” si dhe Rregullore nr. 40, datë 31.03.2016 “Mbi formën, përmbajtjen dhe rregullat për mbajtjen e regjistrave të ndërmjetësve në sigurime” të cilat përafrojnë pjesërisht Direktivën 2002/92/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 9 Dhjetor 2002, për ndërmjetësimin në sigurime.

Për kapitullin 10 “Shoqëria e informacionit dhe media” dhe në përmbushje të detyrimeve të neneve 102, 103, 104 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit është miratuar:

- Ligji nr. 120/2016, datë 24.11.2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, i cili përaftron plotësisht Direktivën 2014/61/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 15 maj 2014, “Mbi masat për reduktimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë”;
- Vendimi i Bordit të Autoritetit të Mediave Audiovizive nr. 55, datë 4.04.2016 “Për miratimin e Rregullores ‘Mbi dhënien e licencave audio të komunitetit’ i cili është i përafuar me Direktivën 2010/13/KE;
- Vendimi i Bordit të Autoritetit të Mediave Audiovizive nr. 153, datë 18.07.2016 “Për miratimin e Rregullores ‘Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio’ i cili është i përafuar me Direktivën 2002/20/KE;
- Vendimi i Bordit të Autoritetit të Mediave Audiovizive nr. 219, datë 12.10.2016 “Për miratimin e rregullores ‘Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare së shërbimit të programit audioviziv”.

Në lidhje me kapitullin 11 “Bujqësia dhe zhvillimi rural” (neni 95 “Bujqësia dhe sektori agro-industrial” i MSA-së) janë miratuar Ligji Nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre” i cili është në përputhje të plotë me Rregulloren (KE) 834/2007 e datës 28 qershor 2007 mbi prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike.

Në fushën e fitosanitetit (kapitulli i 12), u miratua Ligji Nr. 105, datë 27.10.2016 “Për mbrojtjen e bimëve” i cili është në përputhje të pjesshme me Direktivën 2000/29/KE e datës 8 maj 2000 mbi masat mbrojtëse kundra organizmave të dëmshme të bimëve dhe shpërndarjes së tyre në Komunitet.

Në fushën e peshkimit (kapitulli 13), u miratua Ligji 103/2016 “Për akuakulturën” i cili është në përputhje të pjesshme me Rregulloren (BE) Nr. 508/2014 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 15 Maj 2014.

Në përputhje me nenin 106 “Transporti” të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe për përafrimin e *acquis* së BE-së në sektorin e transportit janë miratuar aktet ligjore të mëposhtme:

- Vendimi Këshillit të Ministrave nr. 811, datë 16.11.2016 “Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe planit të veprimit 2016–2020”;
- Ligj nr. 10/2016, datë 11.02.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, i cili është i përafuar pjesërisht me Direktivën 2010/40/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 7 qershor 2010, “Mbi kuadrin për vendosjen e sistemeve inteligjente në transport në fushën e transportit rrugor dhe për lidhjen me mënyrat e tjera të transportit”, Direktivën 2006/22/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 15 mars 2006, “Mbi kushtet minimale për implementimin e rregulloreve të Këshillit (KEE) nr. 3820/85 dhe (KEE) nr. 3821/85 në lidhje me legjislacionin social në veprimtaritë e transportit rrugor, e cila shfuqizon direktivën e

Këshillit 88/599/KEE”, Direktivën 2003/59/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 15 korrik 2003, “Mbi kualifikimin fillestar dhe trajnimin periodik të drejtuesve të disa mjeteve rrugore për transportin e mallrave dhe udhëtarëve, që amendon Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 3820/85 dhe Direktivën e Këshillit 91/439/KEE dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit 76/914/KEE”, Rregulloren (KE) nr. 1071/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 tetor 2009, “Mbi vendosjen e rregullave të përbashkëta në lidhje me kushtet që duhet të plotësohen për ushtrimin e profesionit të operatorit të transportit rrugor, e cila shfuqizon direktivën e Këshillit 96/26/KE”, Rregulloren (KE) nr. 1072/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 tetor 2009, “Mbi rregullat e përbashkëta për hyrjen në tregun ndërkombëtar të transportuesve rrugore të mallrave”;

- Ligj nr. 142/2016, datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, i cili është i përafuar pjesërisht me Direktivën 2012/34/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 nëntor 2012 “Për krijimin e një zone të vetme evropiane hekurudhore”, Direktivën (BE) 2016/798 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 maj 2016 “Mbi sigurinë hekurudhore”, Direktivën (BE) 2016/797 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 maj 2016 “Mbi ndërveprimin e sistemit hekurudhor brenda Bashkimit Evropian”, Direktivën 2007/59/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 23 tetor 2007 “Mbi certifikimin e makinistëve të lokomotivave dhe trenave operative në sistemin hekurudhor në Komunitetin Evropian”, të ndryshuar, Rregulloren (BE) 2016/976 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 maj 2016 “Për Agjencinë e Bashkimit Evropian për Hekurudhat dhe që shfuqizon rregulloren (KE) nr. 881/2004”, Rregulloren (KE) 1370/2007 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23 tetor 2007 “Për shërbimet e transportit publik të udhëtarëve me hekurudhë dhe rrugë dhe që shfuqizon Rregulloret e Këshillit (KEE) nr. 1191/69 dhe nr. 1107/70”, Rregulloren (KE) 1371/2007 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 23 tetor 2007 “Mbi të drejtat dhe detyrimet e pasagjerëve hekurudhorë”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 520, datë 13.7.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 325, datë 19.3.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”, të ndryshuar, i cili është i përafuar pjesërisht me Rregulloren (KE) nr. 1071/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 tetor 2009, “Mbi vendosjen e rregullave të përbashkëta në lidhje me kushtet që duhet të plotësohen për ushtrimin e profesionit të operatorit të transportit rrugor, e cila shfuqizon direktivën e Këshillit 96/26/KE”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 809, datë 16.11.2016 “Për miratimin e rregullore “Për zbatimin e Kodit Ndërkombëtar të Menaxhimit të Sigurisë (ISM Code)”, i cili është plotësisht i përafuar me Rregulloren 336/2006, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 15 shkurt 2006, mbi zbatimin e Kodit Ndërkombëtar të Menaxhimit të Sigurisë brenda Komunitetit dhe shfuqizimin e Rregullore së Këshillit (KE) Nr. 3051/95;

- Udhëzim i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 682/4, datë 1.4.2016 “Për aktivitetin e autoshkollave, pajisjen e kandidatëve me lejedrejtimi, kualifikimin e instruktorëve të autoshkollave dhe specialistëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR)”, i cili është i përafuar plotësisht me Direktivën nr. 2006/126/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të 20 dhjetorit 2006, mbi lejet e drejtimit;
- Udhëzim i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 1362, datë 16.3.2016 “Mbi rregullat në vendosjen e tarifave të aeroportit”, i cili është i përafuar plotësisht me Direktivën e Parlamentit Evropian dhe Këshillit nr. 2009/12/KE, të 11 marsit 2009, “Për tarifën e aeroportit”.

Në lidhje me nenin 107 “Energjia” të MSA-së, është miratuar Ligji nr. 116/2016, datë 10.11.2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave”, i cili është i përafuar pjesërisht me Direktivën 2010/31/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 maj 2010, “Për performancën e energjisë së ndërtesave”.

Nenet 46, 47, 48, 77, kushtet e punës dhe mundësitë e barabarta, neni 99, bashkëpunimi social të MSA-së, janë miratuar:

- Ligji Nr. 65/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë”, i cili përfaqëson Direktivën 98/59/KE, Direktivën 2001/23/KE, Direktivën 2001/23/KE;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 18.05.2016 “Për miratimin e Planit të veprimit të Politikave të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 483, datë 29.6.2016 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2016–2020”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 484, datë 29.6.2016 “Për miratimin e rregullores “Mbi mbrojtjen e punëmarrësve nga risqet lidhur me asbestin në vendin e punës”, i cili është plotësisht i përafuar me Direktivën 2009/148/KE, të datës 30 nëntor 2009, për mbrojtjen e punëmarrësve nga rreziku i ekspozimit ndaj asbestit gjatë punës;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 549, datë 27.7.2016 “Për indeksimin e pensioneve”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 87, datë 3.02.2016 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave të Përfshirjes Sociale”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 14.9.2016 “Për zbatimin e ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 733, datë 20.10.2016 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore, Reduktimit të Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje, dhe Plani i Veprimit”.

Në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë janë miratuar këto akte kryesore:

- Ligji Nr. 71/2016, datë 7.07.2016 “Për kontrollin kufitar”, i cili është pjesërisht i përafuar me rregulloren (BE) 2016/399 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 9 mars 2016, “Mbi Kodin e Bashkimit Evropian që përcakton rregullat e regjimit të lëvizjes së personave përmes kufijve (Kodi i Kufijve Schengen)”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 745, datë 26.10.2016 “Për kryerjen e verifikimeve të përbashkëta kufitare”, i cili është pjesërisht i përafuar me Rregulloren (BE) 2016/399 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 9 mars 2016 “Mbi Kodin e Bashkimit Evropian që përcakton rregullat e regjimit të lëvizjes së personave përmes kufijve (Kodi i Kufijve Schengen)”
- Udhëzim i përbashkët i Ministrisë të Punëve të Brendshme dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Nr. 515, datë 27.9.2016 “Për përpunimin e të dhënave personale nga rojet kufitare”, i cili është pjesërisht i përafuar me Rregulloren (BE) 2016/399 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 9 mars 2016 “Mbi Kodin e Bashkimit Evropian që përcakton rregullat e regjimit të lëvizjes së personave përmes kufijve (Kodi i Kufijve Schengen)”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 814, datë 26.11.2014 “Për një shtesë në vendimin nr. 663, datë 17.7.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme dhe terrorizmit, 2013-2020 dhe planit të veprimit për vitet 2013-2016”, të ndryshuar.

Në kuadër të nenit 109 të MSA-së, dhe kapitullit 25 “Shkenca dhe kërkimi shkencor”, u miratua ligji nr 16/2016, datë 10.3.2016 “Për ratifikimin e marrëveshjes për themelimin e Qendrës së Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit të Ballkanit Perëndimor (WISE)”.

Në plotësim të nenit 70 dhe nenit 100 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, për kapitullin 26 “Arsimi” është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 11, datë 11.1.2016 “Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar për periudhën 2014-2020”.

Në fushën e mjedisit, neni 108 “Mjedisi” i MSA-së, u miratua Ligji Nr. 27, datë 17.03.2016 “Mbi menaxhimin e kimikateve” i cili është në përputhje të pjesshme me Rregulloren 1907/2006/KE e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 18 dhjetor 2006 në lidhje me Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikateve (REACH), krijimin e Agjencisë Evropiane të Kimikateve ECHA, si dhe Rregulloren 1272/2008/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 16 dhjetor 2008 mbi Klasifikimin, Etiketimin dhe Paketimin e Substancave dhe Përzierjeve.

Gjithashtu janë miratuar Vendimet e Këshillit të Ministrave si më poshtë vijon:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 379, datë 25.5.2016 “Për miratimin e rregullores “Cilësia e Ujit të Pijshëm”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 342, datë 4.05.2016 “Për miratimin e kufijve territorial dhe hidrografik të baseneve ujore në RSH dhe qendrën dhe përbërjen e këshillit të secilit prej tyre”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 372, datë 18.5.2016 “Për miratimin e rregullave të komunikimit, konsultimit dypalësh dhe vendimmarrjes për lejen e mjedisit të tipit A, për funksionimin e instalimit të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që ka mundësi reale të krijojë efekte negative të konsiderueshme në mjedisin e një shteti tjetër, ose menjëherë pasi i kërkohet nga ky shtet”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 489, datë 29.06.2016 "Lista e substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC), kriteret për përfshirjen e substancave në listën e SVHC dhe lëshimi i një autorizimi të kushtëzuar me qëllim vazhdimin e përdorimit të SVHC”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 488, datë 29.6.2016 “Mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e kimikateve”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 487, datë 29.06.2016 “Për klasifikimin e produkteve biocide”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 662, datë 21.09.2016 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 652, datë 14.09.2016 “Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 665, datë 21.09.2016 “Për importin dhe eksportin e kimikateve të rrezikshme”.

Në kapitullin 28 “Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndeti” është miratuar Ligji nr. 15/2016, datë 10.03.2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” i cili përafrohet pjesërisht Vendimin nr. 1082/2013/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 22 tetor 2013 “Mbi kërcënimet serioze ndërkufitare për shëndetin, i cili shfuqizon vendimin nr. 2119/98/KE”, Vendimin e Komisionit 2000/96/KE, datë 22 dhjetor 1999, “Mbi sëmundjet e transmetueshme që do të mbulohen në mënyrë progresive nga rrjeti i Komunitetit, sipas vendimit nr. 2119/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit”.

Në plotësim të detyrimeve të nenit 70-të për kapitullin 30 “Marrëdhëniet me jashtë”, dhe kapitullin 31 “Politika e jashtme, sigurisë dhe mbrojtjes”, është miratuar kjo masë ligjore:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 703 datë 12.10.2016 “Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive, me përdorim të dyfishtë, që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import-eksporteve”, i cili përafrohet plotësisht Rregulloren (BE) 2015/2420, deleguar nga Komisioni, e 12 tetorit 2015, për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 428/2009 “Për vendosjen e një regjimi komunitar për kontrollin e eksportit, transferimit, ndërmjetësimit dhe transitit të sistemeve me përdorim të dyfishtë”, dhe Listën e Përbashkët Ushtarake të Bashkimit Evropian, miratuar nga Këshilli me datë 9 shkurt 2015 (pajisjet e mbuluara nga Pozicioni

i Përbashkët i Këshillit 2008/944/PPJS që përcakton rregullat e përbashkëta që rregullojnë kontrollin e eksporteve të teknologjisë dhe pajisjeve ushtarake).

Përkthimi i legjislacionit të Bashkimit Evropian në gjuhën shqipe

Gjatë 2016, Ministria e Integritimit Evropian përfundoi përkthimin dhe rishikimin e 6840.38 faqe të akteve të *acquis* së BE-së nga gjuha angleze në shqip, si edhe 125.76 të akteve të legjislacionit shqiptar nga gjuha shqipe në atë angleze. Janë ngritur të gjithë komisionet *ad hoc* të rishikimit të përkthimit të *acquis* të BE-së. Ndërkaq ka përfunduar rishikimi i Manualit të Përbashkët të termave mes Kosovës dhe Shqipërisë dhe pritet takimi i radhës për të finalizuar këtë Manual.

6. Bashkëpunimi me Bashkimin Evropian

Të gjitha institucionet e përbashkëta Shqipëri – Bashkimi Evropian ngritur bazuar në dispozitat e Titullit X të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit funksionuan rregullisht gjatë vitit 2016.

Takimi i 8-të i Këshillit të Stabilizim-Asociimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian u zhvillua me datë 8 shtator 2016. Takimi u kryesua nga Kryeministri i Shqipërisë ndërsa delegacioni i Bashkimit Evropian kryesohej nga Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Çështjet e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë dhe Zëvendës-presidenti i Komisionit Evropian kurse Komisioni Evropian përfaqësohej nga Komisioneri për Fqinjësinë dhe Negociatat e Anëtarësimit. Delegacioni shqiptar kishte në përbërje të tij Ministrin e Punëve të Jashtme, Ministrin e Integritimit Evropian dhe Kryetarin e Komisionit Parlamentar për Integritimin Evropian të Kuvendit të Shqipërisë.

Këshilli i Stabilizim-Asociimit theksoi faktin se Raporti i Komisionit për Shqipërinë për vitin 2015 arriti në konkluzionin se Shqipëria kishte bërë përparim të mëtjshëm në plotësimin e kriterit politik të anëtarësimit, dhe se në tërësi, kishte vazhduar përparimi i qëndrueshëm në plotësimin e pesë prioritetëve kyçe për hapjen e negociatave. Bashkimi Evropian mirëpriti miratimin në muajin korrik 2016 të ndryshimeve kushtetuese që i hapën rrugën reformës në drejtësi, si dhe miratimin e Ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Këshilli theksoi se reforma në drejtësi mbetet kyçi për përparimin e mëtjshëm të Shqipërisë në procesin e anëtarësimit. Kjo reformë do të ndikojë po ashtu, pozitivisht edhe në realizimin e reformave të tjera të rëndësishme.

Këshilli konfirmoi se Shqipëria ka ruajtur në tërësi ritmin në reformën në administratën publike. Bashkimi Evropian vërejtë se Shqipëria kishte ndërmarrë hapa të mëtjshëm në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ashtu edhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Këshilli i Stabilizim-Asociimit mirëpriti pjesëmarrjen aktive të Shqipërisë në iniciativat dhe strukturat rajonale në Evropën Juglindore. Bashkimi Evropian vlerësoi se Shqipëria është një partner proaktiv dhe konstruktiv në rajon. Këshilli i Stabilizim-Asociimit vlerësoi se Shqipëria

në politikën e saj të jashtme është në përputhje të plotë me deklaratat dhe vendimet e Këshillit të Bashkimit Evropian në politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë.

Në fjalën e saj gjatë konferencës së përbashkët për shtyp, Znj. Mogherini vlerësoi përparimin e bërë duke theksuar “Ju po bëni gjëra të mëdha, sukcesi juaj është sukses për Evropën”.

Komiteti Parlamentar i Stabilizim-Asociimit Shqipëri – Bashkimi Evropian zhvilloi një takim gjatë vitit 2016, në datat 19 – 20 maj 2016, në Tiranë. Takimi u fokusua në diskutimin e marrëdhënieve Shqipëri – Bashkimi Evropian, dialogun politik, reformën e sistemit të drejtësisë dhe zbatimin e Ligjit nr. 138/2015, datë 17.12.2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, reformën elektorale, migracionin dhe bashkëpunimin rajonal.

Ministria e Integritimit Evropian gjatë tremujorit të dytë të vitit 2016, koordinoi dhe përgatiti takimin e shtatë të Komitetit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Evropian – Shqipëri, i cili u zhvillua në Tiranë me datë 9 qershor 2016. Takimi u drejtua nga Z. Klajda Gjoshja, Ministër i Integritimit Evropian. Delegacioni i Bashkimit Evropian kryesohej nga Drejtoresha për Ballkanin Perëndimor në Drejtorinë e Zgjerimit të Komisionit Evropian, Znj. Genoveva Ruiz-Calavera. Në këtë takim, pala shqiptare bëri një përmbledhje të përparimit të Shqipërisë në plotësimin e Kriterëve të Kopenhagenit. Në veçanti, pala shqiptare paraqiti zhvillimet për sa i përket funksionimit të Kuvendit të Shqipërisë, reformës në drejtësi dhe asaj zgjedhore, plotësimin të pesë rekomandimeve të Komisionit Evropian duke përfshirë reformën në administratën publike, luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Pala evropiane mirëpriti zhvillimet në Shqipëri dhe theksoi rëndësinë e veçantë të reformës në drejtësi dhe impaktin që ajo ka për zhvillimin e vendit dhe të marrëdhënieve Bashkimi Evropian – Shqipëri.

Përveç sa më sipër, nën koordinimin e Ministrisë së Integritimit Evropian u zhvilluan takimet e:

- Nënkomitetit Drejtësia, Liria dhe Siguria, me datë 3 – 4 mars 2016, në Tiranë;
- Nënkomitetit Bujqësia dhe Peshkimi, me datë 10 mars 2016, në Tiranë;
- Nënkomitetit Inovacioni, Shoqëria e Informacionit dhe Politikat Sociale, me datë 14 prill 2016, në Bruksel;
- Nënkomitetit Transporti, Energjia, Mjedisi dhe Zhvillimi Rajonal, me datë 21 prill 2016, në Bruksel;
- Nënkomitetit Tregtia, Industria, Doganat dhe Tatimet, me datë 12 maj 2016, në Bruksel;
- Nënkomitetit Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe të shëndetit, me datë 26 maj 2016, në Tiranë;
- Nënkomitetit Çështjet Ekonomike, Financiare dhe Statistikat, me datë 15 nëntor 2016, në Tiranë.

Gjithashtu, nën koordinimin e Ministrisë së Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike u zhvillua takimi i Grupit të Posaçëm për Reformën në Administratën Publike, me datë 8 mars 2016, po në Tiranë.

Për të gjitha këto takime, Ministria e Integritit Evropian dhe Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, si ministri koordinuese, në bashkëpunim me ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, hartuan raportimet përkatëse për shërbimet e Komisionit Evropian, koordinuan zhvillimin e takimit për palën shqiptare dhe përfunduan miratimin e minutave dhe rekomandimeve për takimet e sipërpërmendura. Gjithashtu, për disa nga këto takime janë hartuar informacione plotësuese e sqaruese që iu paraqitën shërbimeve të Komisionit Evropian.

7. Programimi dhe monitorimi i fondeve IPA për vitet 2014, 2015 dhe 2016

Gjatë periudhës raportuese, lidhur me programimin dhe monitorimin e fondeve IPA, me propozim të Ministrisë së Integritit Evropian qeveria ka miratuar vendimin “*Për miratimin në parim të Marrëveshjes së Financimit mbi Programin e Veprimit për vitin 2015 për Shqipërinë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian*”. (VKM Nr. 686, datë 29.09.2016). Marrëveshja u nëshkrua nga Koordinatori Kombëtar i Instrumentit të Paraaderimit (KKIPA) në datë 30 shtator 2016. Kontributi maksimal i Bashkimit Evropian në këtë program është përcaktuar në vlerën 89,9 milionë euro.

Programi Veprues për vitin 2015 do të mbështesë veprimet si më poshtë vijon:

Për mbështetje buxhetore:

Veprimi 1: Reforma në Sektorin e Administratës Publike – (Totali 32 milionë euro) - 28 milionë euro mbështetje buxhetore dhe 4 milionë euro asistencë teknike;

Veprimi 2: Sektori i Punësimit dhe Aftësive – (Totali 30 milionë euro) - 27 milionë euro mbështetje buxhetore dhe 3 milionë euro asistencë teknike;

Projekte të veçanta:

Veprimi 3: Fondi i BE-së për Integrimin (EU integration facility)–13,9 milionë euro

Veprimi 4: Mbështetje për Pjesëmarrjen në Programet Europiane (Union Programmes) - 1 milionë euro;

Veprimi 5: Forcimi i Institucioneve për Zbatimin e Ligjit – mbështetje për Policinë e Shtetit - 13 milionë euro (6 milionë euro asistencë teknike (PAMECA V) dhe 7 milionë euro pajisje).

Në kuadër të përhithjes së fondeve për këtë program, dy institucionet që do të përfitojnë fonde nga mbështetja buxhetore, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike, kanë përgatitur dhe dërguar nëpërmjet Zyrtarit të Lartë të Akredituar pranë Komisionit Evropian në datën 17 Shtator 2016, kërkesat për marrjen e transhit të parë të SBS (Reforma në Administratën Publike prej 7 milionë euro dhe Punësimi prej 6 milionë euro), si dhe dokumentat e tjera që sigurojnë arritjen e katër kushteve për marrjen e mbështetjes buxhetore.

Programimi i IPA 2016

Gjatë vitit 2016 ka vijuar procesi i draftimit dhe finalizimit të Dokumenteve të Veprimit për Programin IPA 2016. Ministria e Integritit European ka koordinuar këtë proces me ministritë e linjës të përfshira në këtë program vjetor, për finalizimin me sukses të Dokumenteve të Veprimit dhe paraqitjen e tyre në Fast Committee, i cili mbahet në Bruksel, ku shtetet anëtare japin miratimin e tyre për mbështetjen e paketës së projekteve të dorëzuara nga pala shqiptare.

Në këtë kuadër, veçanërisht për sektorët që kanë përfituar mbështetje buxhetore ka qënë thelbësore plotësimi i parakushteve të vendosura nga KE. Për rrjedhojë në datën 19 korrik 2016, është prezantuar dhe miratuar Raporti i Monitorimit për Anti-Korrupsionin (si parakusht kryesor për mbështetjen buxhetore) nga të gjithë anëtarët e Grupit Tematik. Ky raport u miratua edhe në nivel të Grupit për Menaxhimin e Integruar të Politikave, në datën 2 shtator 2016. Gjithashtu, Sektori i Transportit ka miratuar Strategjinë Sektoriale, si parakusht kryesor për mbështetjen buxhetore, në nëntor 2016.

Gjatë takimit të Fast Committee të mbajtur në muajin nëntor 2016, Ministria e Integritit European është informuar nga shërbimet e Delegacionit të BE-së në Tiranë, se është marrë vendimi pozitiv dhe pritet dokumenti zyrtar miratues i Komisionit European për paketën prej 64.9 milionë euro, përkatësisht për Programin IPA 2016.

Pas miratimit të Dokumenteve të Veprimit në Fast Committee, për sektorët që do të përfitojnë mbështetje buxhetore, është vijuar gjatë muajit dhjetor 2016 me takime mbi finalizimin e Kontratës së Reformës Sektoriale, e cila përfshin miratimin indikatorëve nga dy institucionet përfituese, Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore dhe Ministria e Transportit.

Finalizimi i indikatorëve që do të mbyllet gjatë muajit janar-shkurt 2017, do të mundësojë edhe dërgimin e paketës finale për programin IPA 2016, e cila pas kalimit të procedurave të brendshme do të nënshkruhet nga KKIPA brenda vitit 2017.

Dokumentet e Veprimit potenciale për të përfituar nga fondet **IPA 2016** janë:

Për mbështetje buxhetore:

1. Sektori i transportit - 24 milionë euro (21 milionë euro mbështetje buxhetore dhe 3 milionë euro asistencë teknike);
2. Anti-korrupsioni –10 milionë euro (9.6 milionë euro mbështetje buxhetore dhe 400 mijë euro asistencë teknike)

Projekte të veçanta:

1. Sektori i bujqësisë (siguria ushqimore dhe peshkimi) - 8.7 milionë Euro;
2. Sektori i ujit - 4 milionë Euro;
3. Fondi i BE-së për integrimin (EU integration facility) – 4.74 milionë euro;
4. Mbështetje për pjesëmarrjen në programet europiane - 1 milionë Euro;

5. Konsolidimi i sistemit të drejtësisë në Shqipëri - 12.5 milionë euro (mbështetje për EURALIUS me 7.5 mln Euro dhe procesin e vetingut 5 mln Euro).

Programimi i IPA 2017

Gjatë vitit 2016 ka vijuar paralelisht me programimin e IPA 2016 edhe programimi i IPA 2017. Në shkurt 2016, Ministria e Integritit European në bashkëpunim me misionin e ardhur nga Bashkimi European, si edhe bazuar në dokumentin e SKZHI dhe Dokumentin Strategjik Kombëtar, kanë vendosur fushat prioritare për mbështetje nga BE për vitin 2017. Konkretisht, prioritetet e përcaktuara janë për sektorin e drejtësisë, ujit, konkurrencës e inovacionit, fondi i BE-së për integrimin european (EU Integration Facility), mbështetja për pjesëmarrjen në programet europiane si dhe shoqëria civile.

Ministria e Integritit European në bashkëpunim me ministritë përkatëse kanë vijuar me procesin e programimit të fondeve për IPA 2017, sipas kalendarit të afateve të programimit të dërguar nga shërbimet e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë. Gjatë muajit dhjetor 2016, për sektorin e drejtësisë dhe sektorin e ujit janë dërguar pranë Komisionit European, Dokumentet e Planifikimit Sektorial (SPD) si dhe draftet e para të Dokumenteve të Veprimit. Ndërsa për sektorin e konkurrueshmërisë dhe inovacionit me fokus turizmin dhe trashëgiminë kulturore, është dërguar pranë Shërbimeve të Komisionit European, drafti i parë i Dokumentit të Planifikimit Sektorial (SPD) dhe pritet së shpejti të fillojë procesi i draftimit të Dokumentit të Veprimit.

Për sa më sipër, nga muaji shtator 2016 deri në muajin qershor 2017, të tre institucionet lider për sektorët e drejtësisë, ujit dhe konkurrueshmërisë dhe inovacionit, kanë patur mbështetjen e ekspertëve ndërkombëtarë të përzgjedhur nëpërmjet një kontrate asistence, me qëllim ndihmesën e institucioneve shqiptare mbi hartimin dhe finalizimin e SPD-ve dhe DV-ve. Shumat indikative për sektorët përkatës të Programit IPA 2017 nuk janë përcaktuar akoma.

Përditësimi i Dokumentit Strategjik Kombëtar 2014-2020

Gjatë muajit shtator 2016, shërbimet e Komisionit kanë dërguar pranë Ministrisë së Integritit European udhëzuesin mbi mënyrën dhe afatet e rishikimit të Dokumentit Strategjik Kombëtar (DSK) 2014 – 2010, proces i cili do të konkludojë me një dokument të rifreskuar me prioritetet kombëtare për vitet 2017 – 2020. Ministria e Integritit European, në rolin e KKIPA ka informuar ministritë e linjës dhe institucionet qendrore mbi udhëzuesin dhe procedurat e rishikimit. MIE, në bashkëpunim me Departamentin e Zhvillimit, Financimit dhe Ndihmës së Huaj në Kryeministri, ka organizuar dy takime konsultative me institucionet kombëtare, me qëllim përcaktimin e prioriteteve të mundshme kombëtare për mbështetje nga fondet IPA, pjesë e DSK.

Paketa e prioriteteve kombëtare i është dërguar për reflektim Delegacionit të BE-së në Tiranë, në fillim të tetorit 2016. KKIPA është ende në pritje të dërgimit nga ana e tyre të draft Dokumentit Strategjik Kombëtar, të rishikuar nga shërbimet e Komisionit European, me qëllim zhvillimin e një raundi tjetër konsultimi me institucionet kombëtare.

Amendimi i Marrëveshjes Financiare 2013

Gjatë muajve nëntor – dhjetor 2016, janë bërë ndryshime mbi Marrëveshjen Financiare IPA 2013 dhe mënyrën e alokimit të disa fondeve. Konkretisht ndryshimet në Marrëveshjen Financiare IPA 2013, kanë pasur për qëllim rregullimin e financimit dhe mënyrës së menaxhimit të asistencës financiare të Bashkimit Europian për reformën në drejtësi dhe veçanërisht procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si edhe mbështetjen me një grant pasues për Misionin e Asistencës Europiane për Sistemin Shqiptar të Drejtësisë (Euralius IV).

Kjo mbështetje është realizuar me rialokimin e 3.5 milionë Euro nga projekti i Gjykatës së Tiranës, i cili është anuluar, si edhe nëpërmjet rialokimeve nga projektet për reformën e policisë (pajisjet e përgjimit, 1 milionë Euro), për rrugët rurale (1.8 milionë Euro), dhe doganat (0.3 milionë Euro). Shuma totale prej 6.6 milionë euro është e ndarë si më poshtë: 5 milionë euro për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve (procesi i vetting-ut), dhe 1.6 milionë euro për zgjatjen e afatit të mandatit të projektit në vazhdim EURALIUS.

Ndryshimet e shtesës nr.1 dhe shtesës nr.2 të Marrëveshjes së Financimit në lidhje me programin kombëtar për Shqipërinë në kuadër të komponentit IPA “Asistenca e tranzicionit dhe mbështetja institucionale” për vitin 2013, janë miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave me VKM nr. 937, datë 28.12.2016 dhe nënshkruar më datë 30.12.2016 nga KKIPA.

Programi i IPA me shumë vende përfituese

Në lidhje me IPA me shumë vende përfituese (IPA MC) për vitin 2016 - gjatë periudhës shkurt 2016, KE ka përcjell në vendet përfituese 10 dokumentet e veprimit. Ministria e Integritit Europian ka konsultuar këto dokumente veprimi me ministritë e linjës dhe institucionet të tjera qendrore. Në vijim, në datën 20 korrik 2016, Komisioni Europian ka miratuar Vendimin Zbatues C (2016) 4893, për Programin e veprimit për IPA me shumë vende përfituese për vitin 2016. Shuma e alokuar për të gjithë rajonin është 41, 285, 000 Euro.

IPA me shumë vende përfituese 2016 siguron mbështetje për lehtësimin e tregtisë së lirë nëpërmjet mbështetjes së sekretariatit të CEFTA-s, mbështetje në zbatimin e Strategjisë së Europës Juglindore, mbështetje për komunitetin romë, mbështetje për rininë, energjinë e rinovueshme, ndryshimet klimatike, mjedisin, etj.

Lidhur me IPA me shumë vende përfituese 2017, në takimin koordinues organizuar më 26-27 maj 2016, Shqipëria dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, kanë diskutuar mbi prioritetet për t'u mbështetur nga IPA MC për vitin 2017. Veç prioritetëve të propozuara nga KE, janë diskutuar dhe disa projekt-ide të propozuara nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu, gjatë periudhës tetor-nëntor 2016 janë konsultuar draft dokumentet e veprimit për IPA MC 2017. Në nëntor 2016 është zhvilluar takimi koordinues midis zyrave mbështetëse të KKIPA-ve të vendeve të rajonit dhe Komisionit Europian për të diskutuar komentet dhe sugjerimet e dhëna nga aktorët e ndryshëm të vendeve pjesëmarrës. IPA me shumë vende përfituese 2017 siguron mbështetje për forcimin e administratës publike, statistikën, politikën e sigurisë së brendshme, turizmin, ndryshimet klimatike, mjedisin, reduktimin e rrezikut të fatkeqësive natyrore. Në datën 20 korrik

2016, Komisioni Europian ka miratuar Vendimin Zbatues C (2016) 4889, për Instrumentin Lehtësues për Shoqërinë Civile dhe Programin për Median për vitet 2016-2017. Shuma e alokuar është respektivisht 49,010,000 Euro për vitin 2016 dhe 38,310,000 Euro për vitin 2017.

Në kuadër të rishikimit afatmesëm të Dokumentit Strategjik të IPA me shumë vende përfituese, Ministria e Integritit Europian gjatë nëntorit 2016 ka realizuar konsultimin e këtij draft-dokumenti me ministritë e linjës dhe institucione të tjera qendrore. Ky dokument përcakton prioritetet dhe kushtet për arritjen e tyre në nivel rajonal dhe horizontal, përfshirë këtu dhe bashkëpunim territorial. Qëllimi i këtij rishikimi është për të vendosur nëse Strategjia e miratuar në vitin 2014 është ende relevante duke marrë parasysh zhvillimet e fundit të vendeve të rajonit dhe Turqisë.

Instrumenti i Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF)

Në kuadër të thirrjes së 15-të të thirrjeve për projekt-propozime për projekte të asistencës teknike, Ministria e Integritit Europian në bashkëpunim me Departamentin e Zhvillimit, Financimit të Ndhmës së Huaj në Kryeministri dhe mbështetjen e asistencës financiare rajonale International Financing Institution Coordination Office (IFICO)/WBIF, kanë zhvilluar takime të veçanta konsultative me ministritë e linjës në mënyrë që të evidentojnë projektet që do të propozohen në këtë thirrje. Në shkurt 2016, Shqipëria nëpërmjet zyrës mbështetëse të KKIPA aplikoi për 5 projekt propozime për asistencë teknike (2 në fushën e energjisë, 2 në fushën e transportit dhe 1 në fushën sociale), prej të cilave në Komitetin Drejtues të WBIF mbajtur më 16-17 qershor 2016, u miratuan projektet si më poshtë:

- “Studimi i para-fisibilitetit dhe ndikimit në mjedis për projektin e tubacionit të gazit nga Shqipëria në Kosovë” me vlerë të grantit 300,000 Euro për të dyja vendet. Projekti i gazsjellësit Shqipëri-Kosovë (ALKOGAP) do të shërbejë për të ndërlidhur sistemin ekzistues dhe të planifikuar të transmetimit të gazit në Republikën e Shqipërisë (duke përfshirë edhe projektin TAP) me sistemin e transmetimit të gazit në Republikën e Kosovës, si dhe interkonektorët (ndërlidhësat) e transmetimit që janë pjesë e degës lindore të Unazës së Gazit të Komunitetit të Energjisë (Energy Community Gas Ring, ECGR). Projekti synon që të krijojë një rrugë të re të furnizimit për gazin natyror i cili do të vijë nga Lindja e Mesme dhe rajoni i Kaspikut i transportuar me Gazsjellësin Trans-Adriatik (TAP), në verilindje të zonës së Ballkanit Perëndimor drejt Serbisë. Ndërtimi i këtij tubacioni të transmetimit do të mundësojë gazifikimin e Shqipërisë dhe Kosovës duke garantuar një furnizim të larmishëm dhe të besueshëm të gazit natyror;
- “Studim para-fisibiliteti për gazsjellësin Adriatik-Jonian (IAP)” me përfitues Shqipërinë dhe Malin e Zi me vlerë të grantit për Shqipërinë 250,000 Euro. Gazsjellësi Jonian Adriatik (IAP) lidh sistemin ekzistues të transmetimit të gazit të Kroacisë me TAP. Projekti synon të krijojë një rrugë të re të furnizimit për gazin natyror nga Lindja e Mesme dhe rajoni i Kaspikut, përgjatë bregdetit Adriatik. Ndërtimi i IAP do të sigurojë një furnizim të

qëndrueshëm, të larmishëm dhe të besueshëm të gazit natyror për Shqipërinë, Malin e Zi, Kroacinë jugore dhe Bosnje e Hercegovinën.

- “Dizenjo e detajuar e linjës hekurudhore Vorë – Hani i Hotit”, me vlerë të grantit 800,000 Euro. Për arsye se u konstatua që ky grant nuk ishte i mjaftueshëm të financonte studimin, u krye pranë WBIF një aplikim i dytë në raundin e 16-të, ku projekti fitoi një fond të dytë për të kryer studimin e detajuar për linjën hekurudhore Vorë – Hani Hotit.

Në kuadër të thirrjes së 16-të për projekte për asistencë teknike, Ministria e Integritit European në bashkëpunim me Departamentin e Zhvillimit, Financimit të Ndihmës së Huaj në Kryeministri dhe mbështetjen e asistencës financiare rajonale IFICO/WBIF, zhvilluan procesin e konsultimeve me ministrinë e linjës për të evidentuar projekt-propozimet për aplikim. Në shtator 2016, Shqipëria nëpërmjet zyrës mbështetëse të KKIPA-së, aplikoi për 4 projekt-propozime për asistencë teknike (2 në fushën e energjisë, 1 në fushën e transportit dhe 1 në fushën sociale). Në Komitetin Drejtues të WBIF mbajtur më 15 dhjetor 2016 në Londër u miratuan projektet si më poshtë:

- “Dizenjo e detajuar për By-Passin e Tiranës (Kashar-Vaqarr-Mullet)”, me vlerë të grantit 1,500,000 Euro. Ky projekt i jep zgjidhje problematikës së mbingarkesës së trafikut në kryeqytetin e Shqipërisë. Realizimi i këtij bypass-i rrugor reflekton një dimension të rëndësishëm strategjik për qarkun e Tiranës duke qënë se përfshihet në Korridorin VIII Pan-Evropian dhe si i tillë, është pjesë e rëndësishme e SEETO-s, TEN-T, Western Balkan 6 dhe Master Planit për Transportin Kombëtar të miratuar nga qeveria shqiptare;
- “Dizenjo e detajuar e linjës hekurudhore Vorë – Hani i Hotit”, me vlerë të grantit 4,500,000 Euro. Ky projekt ka për qëllim lidhjen e Shqipërisë dhe Malit të Zi me rrugë hekurudhore. Rehabilitimi i kësaj linje hekurudhore është i rëndësishëm dhe do të sjellë një zhvillim të madh ekonomik për rajonin e Europës Jug-Lindore. Njëkohësisht ky projekt do të mundësojë një impakt të madh për vëndet e Ballkanit Perëndimor duke siguruar akses daljeje në portin e Durrësit dhe në të gjitha nivelet e detit Adriatik drejt portit të Barit dhe me Korridorin tjetër TEN-T, Skandinavi-Mesdhe.

Në kuadër të thirrjes së parë për projekte për bashkëfinancim, të zhvilluar në mars 2016, Ministria e Integritit European në bashkëpunim me Departamentin e Zhvillimit, Financimit të Ndihmës së Huaj në Kryeministri dhe mbështetjen e asistencës financiare rajonale IFICO/WBIF, zhvilluan procesin e konsultimit me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, në lidhje me aplikimin e projektit të investimit “Rehabilitimi i hekurudhës Durrës-Tiranë dhe ndërtimi i hekurudhës së re, dega Rinas”. Ky projekt rezultoi fitues dhe u miratua në takimin e Komitetit Drejtues të WBIF mbajtur më 15 dhjetor 2016 në Londër.

Projekti i investimit “Rehabilitimi i hekurudhës Durrës-Tiranë dhe ndërtimi i hekurudhës së re, Dega Rinas” me shumë totale investimi prej 90 043 700 Euro, u miratua për bashkëfinancim nga WBIF me vlerë të grantit 36,243,700 Euro. Ky projekt ka për qëllim të rehabilitojë seksionet

hekurudhore midis Tiranës dhe portit kryesor të Durrësit, si dhe për ndërtimin e një rruge të re hekurudhore midis Tiranës dhe aeroportit ndërkombëtar të Rinasit. Projekti siguron një pjesë të lidhjes të transportit multimodal ndërmjet Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi, si dhe lidhje të mëtejshme të transportit me Greqinë dhe Bullgarinë, përgjatë Korridorit të Mesdheut.

Programet Europiane

Shqipëria vazhdon të marrë pjesë në 8 programe të Bashkimit Evropian, dhe në këtë kuadër janë kryer disa trajnime, takime e aktivitete. Gjatë vitit 2016, MIE së bashku me asistencën teknike ka zhvilluar disa takime informuese me Institucionet përfituese për secilin program evropian. Gjithashtu, MIE së bashku me asistencën teknike projekti “Asistenca Teknike për Programet Evropiane në Shqipëri”, i financuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian për periudhën 2-vjeçare (janar 2016 – janar 2018) dhe Ministrinë e Financave (Fondin Kombëtar) kanë zhvilluar disa takime për institucionet përfituese të Programeve Europiane, me qëllim ndërgjegjësimin e tyre për procesin e pagesës së detyrimit për pjesëmarrje (entry ticket), rimbursimit dhe dokumenteve përkatëse shoqëruese, si dhe zhvillimin e disa trajnimeve për programet e ndryshme.

Gjithashtu, MIE së bashku me projektin e asistencës teknike të sipërpërmendur kanë organizuar disa takime informuese (rreth 45 të tilla) për thirrjet konkrete të programeve të ndryshme evropiane sikurse janë Horizon 2020, Europa Krijuese me komponentet e medias dhe kulturës, Europa për qytetarët, COSME, etj.

Monitorimi i fondeve IPA

Monitorimi i projekteve IPA në zbatim ka vijuar gjatë gjithë vitit 2016. KKIPA ka monitoruar dhe ndërmjetësuar zgjidhjen e çështjeve problematike të projekteve, të centralizuara, të raportuara nga Delegacioni i Bashkimit Evropian (DBE) dhe/ose përfituesit shqiptarë (problematika, të një game të gjerë, që nga sigurimi i fondeve të bashkëfinancimit dhe TVSh nga buxheti i shtetit e deri në vonesat në zhvillimin e punimeve nga firmat zbatuese, etj.).

Ndërmjetësimi, përtej komunikimeve, është kryer edhe përmes zhvillimit të takimeve, kryerjes së vizitave “on the spot”, komunikimeve dhe raportimeve më të shpeshta. Si rezultat i saj, të gjitha projektet problematike i janë kthyer ecurisë normale (duke e ulur në zero numrin e tyre), ndërkohë që janë vetëm 14 projekte nën monitorim të ngushtë të cilët vazhdojnë të mbikëqyren me qëllim rikthimin sa më të shpejtë të rrjedhës së tyre normale. Projektet (e centralizuara), të cilët janë konsideruar problematikë dhe janë zgjidhur, ose ato të cilët janë në monitorim të vazhdueshëm për shkak të problematikave të mëhershme, jepen përmes komponentit të Asistencës Teknike dhe Ngritjes së Institucioneve (TAIB, IPA I), dhe përfshijnë që nga ndërhyrjet në infrastrukturë e deri në ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe/ose përmirësimin e proceseve në nivel qendror. Edhe pse kanalizohen përmes qeverisjes/institucioneve qendrore, projektet, shpesh, kanë impakt vendor rajonal. Të tilla si ndërtimi i kanalizimeve dhe/ose

impianteve të trajtimit të ujërave të zeza (Ksamil, Vlorë, Velipojë, Shëngjin, Kavajë, nga IPA 2009 dhe IPA 2011), projektet në funksion të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe përmirësimi i kushteve të të burgosurve (ndërtimi i qendrës së burgimit Shkodër, IPA 2011), etj.

Gjithashtu, duke konsideruar se ka filluar zbatimi i projekteve/programeve nën menaxhim të decentralizuar/indirekt (programet IPA 2012, 2013 dhe 2014), janë organizuar takimet e Komiteteve drejtuese ku është prezantuar puna për zbatimin e projekteve dhe procedurat lidhur me implementimin dhe monitorimin, si dhe bashkëpunimi me strukturat e MIE në rolin e KKIPA dhe Ministrine e Financave në rolin e Autoritetit Kontraktues. Në cilësinë e KKIPA-s, MIE ka marrë raportet e para (6-mujore) të monitorimit nga institucionet përfituese të projekteve nën menaxhim të decentralizuar. Bazuar në këto raporte, ecuria e projekteve të kontraktuara deri tani ka qenë e mirë dhe sipas planifikimit.

Ministria e Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të tjerë) vazhdon zbatimin e planit të prokurimit për programet IPA 2013 dhe IPA 2014 nën menaxhim të decentralizuar dhe indirekt. Gjithashtu, ka filluar përgatitja lidhur me kontraktimet për programet e decentralizuara nën Programin Kombëtar IPA 2015.

Të gjitha informacionet e mësipërme janë raportuar dhe diskutuar gjatë takimit të Komitetit të përbashkët të monitorimit të fondeve IPA Shqipëri-BE, zhvilluar në Tiranë më 18 janar 2017.

Projekti i parë i decentralizuar, i cili është në implementim IPA 2012 – Ndërtimi i sistemit të Kanalizimeve dhe Impiantit të përpunimit të Ujërave të zeza, Vlorë, faza II-të (15.1 milion Euro, financim IPA) – dhe pse kanalizohet përmes Ministrisë së Transporteve dhe Infrastrukturës (si institucion përfitues), përfituesit finalë të projektit do të jetë Bashkia Vlorë dhe Ndërmarrja e Ujësjiellës-Kanalizimeve e Vlorës, e cila ka një impakt vendor përtej atij qendror. Gjithashtu, në terma financiarë, buxheti i programit të decentralizuar për IPA 2013, është rreth 14.3 milion Euro, nga të cilat rreth 6.3 milion Euro janë kontraktuar, 5.15 milion Euro janë në kontraktim me procedura të hapura dhe 3 kontrata me buxhet 3.5 milion Euro që pritet të fillojnë procesin e prokurimit me finalizimin e dokumenteve teknikë. Më tej buxheti i alokuar për programin e decentralizuar IPA 2014 është rreth 17.3 milion Euro (10.3 milion Euro, Instrumenti Lehtësues për Integrimin (me gjithë nën-komponentët e tij dhe institucionet përfituese), 6 milion Euro mbështetje për reformën në Administratën Publike dhe 1 milion Euro, Mbështetje për Pjesëmarrjen në Programet e BE-së (Union Programmes)¹.

Në kuadrin e programeve të mbështetjes buxhetore, gjatë muajit Gusht 2016 u miratua nga Komisioni Evropian disbursimi i transhit të parë dhe pjesërisht të transhit të dytë (në total 13, 5 milion Euro) të programit të mbështetjes buxhetore për reformën në menaxhimin e financave publike (IPA 20014), pas plotësimit të kushteve dhe indikatorëve përkatës nga autoritetet shqiptare. Për më tepër në 22 Nëntor 2016 u miratua nga Komisioni Evropian lëvrimi i transhit të parë të programit të Reformës në Punësim dhe Aftësim, në shumën 6 milion Euro dhe programit buxhetor të Reformës në Administratën Publike në shumën 7 milion Euro (IPA 2015).

¹ Të gjitha të dhënat financiare i përkasin projekteve të decentralizuara/indirekte, për të cilat institucionet shqiptare janë akredituar për menaxhimin e tyre.

Lidhur me procesin e akreditimit të sistemit të menaxhimit indirekt, është ende në proces adresimi i një pjese të vogël të mbetur të gjetjeve dhe rekomandimeve të misioneve të auditimit të Komisionit European lidhur me marrjen e besimit për menaxhimin indirekt të programeve IPA 2014 dhe 2015 (misionet e datës 15-18 mars 2016; misioni i datës 21 – 25 nëntor 2015), si dhe rekomandimeve të misionit të Komisionit European për sistemin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (misioni 21 – 25 nëntor). Gjithashtu, gjatë muajit dhjetor 2016, pas dërgimit të aplikimit nga ana e autoriteteve Shqiptare, u krye edhe një mision verifikimi në datat 5-9 dhjetor 2016), nga ana e DG-Agri lidhur me gatishmërinë e strukturave Kombëtare për zbatimin e Programit të Asistencës së Zhvillimit Rural (IPARD II). Ky mision pritet të dërgojë draft raportin e parë të gjetjeve/rekomandimeve brenda muajit mars 2017.

8. Bashkëpunimi territorial

Gjatë periudhës raportuese, Ministria e Integritit Evropian në cilësinë e saj si Autoriteti Kombëtar për Bashkëpunimin Territorial, ka punuar në mënyrë të vazhdueshme me strukturat homologe për të mundësuar zbatimin e Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar dhe Transnacional në të cilat Shqipëria merr pjesë gjatë perspektivës IPA II. Rëndësi e vëçantë i është kushtuar nënshkrimit të Marrëveshjeve të Financimit, hartimit dhe shpalljes së thirrjeve për projekt - propozime, ngritjes së strukturave mbështetëse, etj.

Programi IPA CBC Shqipëri-Kosovë 2014-2020 - Ministria e Integritit Evropian, në bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit Evropian (në cilësinë e Autoriteti Kontraktues të Programit) kanë finalizuar gjatë fundit të vitit 2016 Udhëzuesin për aplikantët dhe paketën përkatëse të Aplikimit, të cilat përcaktojnë rregullat e thirrjes për projekt-propozime. Kjo e fundit pritet të lançohet në mes të janarit 2017 dhe do të ketë një buxhet prej rreth 2.1 milionë euro (kontribut i BE). Ndërkohë, theksojmë se gjatë vitit 2016 janë ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të plotësuar me staf Sekretariatit e Përbashët Teknik të Programit (me seli në Kukës), menaxhimin e Projektit të Asistencës Teknike, etj. Mes dy vendeve është nënshkruar në datë 3 qershor 2016, gjatë takimit mes dy qeverive, një marrëveshje partneriteti për zbatimin e përbashkët të Programit.

Programi Trilateral Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi 2014-2020 – Marrëveshja e Financimit për këtë Program është nënshkruar nga Shqipëria më datë 17 nëntor 2016, me një vlerë prej mbi 90 milionë euro, ndërkohë që MIE ka ndjekur të gjitha procedurat për ratifikimin e saj nga Kuvendi i Shqipërisë. MIE ka bashkëpunuar ngushtë me Autoritetin Menaxhues të Programit (Rajoni i Pulias) me qëllim përgatitjen dhe finalizimin e Termave të Referencës për thirrjen e parë për projekt-propozime. Kjo e fundit do të lançohet në muajin mars 2017 dhe mendohet të ketë një vlerë prej mbi 20 milionë euro. Procedurat për rekrutimin e stafit të Sekretariatit Teknik u finalizuan gjatë muajit nëntor 2016, ndërkohë që në shkurt 2017 do të ngrihet edhe Zyra e Informimit në Tiranë (dedikuar për këtë Program). Në mars 2016 u zhvillua në Bari takimi i Nivelit të Lartë mes Sekretarit të Përgjithshëm të MIE, Presidentit të Rajonit Puglia, Presidentit të Rajonit Molise dhe Sekretarit malazez të Shtetit për Integritin Evropian.

Zyrtarët e lartë konfirmuan angazhimin e tyre për zbatimin e projekteve cilësore dhe me impakt për komunitetet respektive.

Programi Interreg IPA CBC Greqi-Shqipëri – Marrëveshja e Financimit (7-vjeçare) për këtë Program është nënshkruar nga Shqipëria më datë 17 nëntor 2016, dhe më pas u nënshkrua dhe nga homologët grekë dhe Komisioni Evropian brenda muajit dhjetor 2016. Në kuadër të këtij programi janë shpallur dy thirrje për propozime dhe konkretisht nga thirrja e parë për projekte strategjike (12 shkurt 2016 - 16 maj 2016) rezultuan 4 projekte të përzgjedhura për kontraktim, të cilat u miratuan dhe nga Komiteti i Përbashkët i Monitorimit në muajin nëntor 2016. Në kuadër të shpalljes së thirrjes u organizuan 3 ditë informuese për përfituesit potencialë në zonat përfituese të programit, konkretisht në Korçë, Gjirokastrë dhe Berat, me pjesëmarrjen e institucioneve lokale, qendrore dhe përfaqësues nga shoqëria civile. Thirrja e dytë për projekte u shpall në datë 17 maj dhe u mbyll me datë 24 tetor 2016 dhe ka rezultuar me një numër prej mbi 200 projektesh të dorëzuara dhe një pjesëmarrje tejet të lartë të aplikantëve shqiptarë. Aktualisht këto projekte janë në proces vlerësimi. Edhe për këtë program stafi i Sekretariatit Teknik është i plotësuar dhe funksional.

Lidhur me **Programin IPA CBC Maqedoni-Shqipëri 2014-2020**, MIE në bashkëpunim me Delegacionin e BE-së në Shkup (në cilësinë e Autoriteti Kontraktues të Programit) kanë hartuar, diskutuar dhe rakorduar për dokumentat e thirrjes së parë për projekt propozime, ku vlen të përmendet Udhëzuesi për Aplikantët. Thirrja e parë për projekt propozime u shpall më datë 16 shtator 2016, dhe qëndroi e hapur deri më datë 1 nëntor 2016. Në kuadër të saj u zhvilluan 3 sesione informuese në qytetet e Dibrës, Korçës dhe Elbasanit, si zona të lejshme të programit. Ministria e Integrimit Evropian, me qëllim forcimin e kapaciteteve të aktorëve lokalë (bashki dhe organizata), organizoi një trajnim dyditor, në Pogradec, me përfituesit e mundshëm që u pasua me një pjesëmarrje tepër të kënaqshme të aplikantëve shqiptarë në këtë thirrje. Aktualisht projekt-aplikimet janë ende në proces vlerësimi nga DBE.

Programi IPA CBC Mali i Zi-Shqipëri 2014-2020– shpalli thirrjen e tij të parë për projekt propozime në periudhën 15 korrik-13 shtator 2016. Gjatë kësaj periudhe u zhvilluan sesione informuese në qytetin e Shkodrës dhe të Lezhës si dhe një trajnim 3-ditor për përfituesit potencialë po në qytetin e Shkodrës. Gjatë periudhës tetor – dhjetor nga strukturat e përbashkëta operuese është ndjekur procesi i vlerësimit të projekteve (koncept-notat) të dorëzura në kuadër të thirrjes së parë për projekte, proces i cili u mbyll brenda muajit dhjetor për t'u përcjellë më pas për miratim nga DBE në Podgoricë. Pasi të miratohet raporti i vlerësimit do të t'u kërkohej aplikantëve të përzgjedhur të dorëzojnë paketën e plotë të aplikimit (pritet të ndodhë gjatë muajit janar 2017). Gjithashtu në mars të vitit 2016, Qeveria Shqiptare miratoi dy marrëveshje financimi, alokimet e viteve 2014 dhe 2015, të cilat i hapën rrugën dhe shpalljes së thirrjes së parë për propozime. Po kështu gjatë këtij viti struktura e Sekretariatit Teknik në Podgoricë u plotësua dhe me stafin përkatës shqiptar duke bërë të mundur funksionimin e plotë të tij.

Përsa i përket **Programit Interreg ADRION** theksojmë se MIE ka luajtur një rol të rëndësishëm në hartimin e Udhëzuesit të Aplikantëve duke e përshtatur atë sa më shumë për kushtet e aplikantëve të mundshëm shqiptarë dhe statusit të tyre ligjor. Thirrja e parë për projekt-propozime u shpall në datën 1 shkurt 2016 dhe qëndroi e hapur deri në datën 25 mars 2016. Në kuadër të shpalljes së thirrjes u organizua një ditë informuese në datën 29 shkurt për përfituesit potencialë në Tiranë. Në këtë thirrje janë përfshirë 2983 aplikantë, nga të cilët 262 aplikantë nga Shqipëria (numri më i lartë krahasuar me vendet e rajonit). Projekt-propozimet janë në proces vlerësimi, i cili pritet të përfundojë në mars 2017. Në lidhje me Marrëveshjen e Financimit për këtë Program, ajo pritet të nënshkruhet në prill të 2017.

Lidhur me **Programin Interreg Ballkan-Mediterranean** projekt propozimet e dorëzuara në kuadër të thirrjes së parë (16 dhjetor 2015 - 26 prill 2016) janë në proces vlerësimi. Me qëllim informimin e aplikantëve shqiptarë dhe trajnimin e tyre mbi modalitetet e aplikimit, MIE organizoi një ditë informuese në shkurt 2016. Pas mbylljes së afatit të kësaj thirrjeje, u vërejt se nga 384 propozime 130 janë me partnerë shqiptarë, çka dëshmon një interes mjaft të lartë që erdhi si pasojë e një fushate informuese efektive nga ana e MIE-së. Procesi i vlerësimit pritet të përfundojë në fund të muajit shkurt 2017. Në lidhje me Marrëveshjen e Financimit për këtë Program, ajo pritet të nënshkruhet në brenda muajit prill të vitit 2017.

Gjatë muajit janar 2016 **Programi Interreg Mesdheu (MED)**, mbylli thirrjen për projekt-propozimet Modul dhe projekt-propozimet Horizontale. Gjatë fazës së vlerësimit të aplikimeve në këto thirrje u vu re një përfshirje e lartë e aplikantëve shqiptarë, krahasuar kjo me vendet e tjera të rajonit. Sekretariati Teknik i Programit, në bashkëpunim me strukturat përkatëse në çdo vend pjesëmarrës në program, po përgatitet për të shpallur thirrjen e dytë për projekt propozime e cila do të shpallet në fund të janarit 2017 dhe parashikohet të qëndrojë e hapur deri në fund të marsit 2017. Marrëveshja e Financimit për programin MED pritet të nënshkruhet në fillim të 2017 dhe aktualisht Struktura Operuese shqiptare është duke përgatitur të gjithë dokumentat e nevojshme për nënshkrimin e saj. Ndërkohë, ka filluar zbatimin e projekteve të para fituese nga Thirrja e Parë e këtij Programi, dhe MIE po asiston partnerët fitues shqiptarë mbi procedurat e zbatimit të projekteve.

Si disa prej arritjeve kryesore për vitin 2016, në mënyrë të përmbledhur, mund të veçojmë:

Ndryshe nga periudha IPA I (2007-2013), tashmë nën qasjen e re IPA II (2014-2020) Programet e bashkëpunimit Territorial janë instrumente të njohura financimi për pjesën më të madhe të partnerëve/palëve/aktorëve të interesuar në Shqipëri, duke përfshirë këtu si autoritete publike ashtu dhe shoqërinë civile.

MIE ka bërë të mundur lidhjen në kohë të Marrëveshjeve të Financimit (MF) për Programet IPA të Bashkëpunimit Territorial (4 bilaterale dhe 1 trilateral). Marrëveshjet e Financimit për tre programet e tjera të bashkëpunimit transnacional pritet të përfundojnë brenda muajit prill 2017.

Numri i aplikantëve shqiptarë në thirrjet për projekt propozime të shpalluar në kuadër të programeve transnacionale, ka qënë më i lartë krahasuar me vendet e tjera të rajoni, dhe kjo për falë një fushate të gjerë informimi të ndërmarrë nga MIE.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar dhe përforcimit të kapaciteteve të bashkive për përthithjen e fondeve të BE-së nëpërmjet programeve të bashkëpunimit ndërkufitar (kjo në përputhje edhe me hartën e re territoriale prodhuar nga Reforma Territoriale). Për këtë qëllim, stafi i MIE-së në bashkëpunim me Shkollën Shqiptarë të Administratës Publike (ASPA) kanë kryer disa sesione trajnuese në Qarqe të ndryshme të vendit.

Në vijim të këtyre aktiviteteve të ndërmarrura nga MIE, është konstatuar një rritje e ndjeshme krahasuar me thirrjet e viteve të shkuara, numri i bashkive, përfshirë këtu edhe ato të vogla, të cilat janë aktive në Programet CBC.

9. Forcimi i kapaciteteve në procesin e integritimit

Në bashkëpunim me Projektin e Binjakëzimit IPA 2012 “Mbështetje në reformën e shërbimit civil në Shqipëri”, projekt i zbatuar nga Shkolla Kombëtare Franceze e Administratës Publike (ENA), Shkolla Kombëtare Italiane e Administratës Publike (SNA) dhe Departamenti i Administratës Publike (DAP), janë organizuar gjatë vitit 2016 katër seminare (workshops) për Sekretarët e Përgjithshëm, Drejtorët e Njësive të Integritimit dhe Përgjegjësit e Sektorëve në Drejtoritë të Integritimit Evropian të ministrive të linjës. Synimi i seminareve ishte përcaktimi i objektivave dhe treguesve, si dhe lehtësimi i zbatimit të metodologjisë për vlerësimin e performancës në punë.

Në kuadër të bashkëpunimit mes vendit tonë dhe Shkollës Rajonale të Administratës Publike (RESPA), është mundur edhe trajnimi i një kategorie të caktuar të nëpunësve civilë në fushat e procesit të integritimit evropian nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në trajnimet që kjo shkollë ofron. Gjatë vitit 2016, është organizuar një trajnim mbi përafrimin e legjislacionit në fazën e para aderimit në BE, një trajnim mbi mbështetjen buxhetore si dhe takime të Grupit të Punës të Komitetit Programues të Integritimit Evropian ku përfaqësues nga vendet e rajonit kanë ndarë praktikën dhe idetë më të mira lidhur me çështjet e integritimit evropian.

Gjatë vitit 2016, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) ka organizuar trajnime me fokus forcimin e kapaciteteve profesionale në kuadër të procesit të integritimit për disa kategori të caktuara të nëpunësve civilë. Më konkretisht, ASPA ka organizuar trajnimet e mëposhtme:

- Menaxhimi i Asistencës Financiare të BE – program trajnimi me kohëzgjatje 14-ditore. Janë zhvilluar 2 programe trajnimi dhe janë trajnuar 40 nëpunës civilë në njësitë e programeve IPA.
- Prokurimi, zbatimi dhe procedurat financiare për Grantet, Kontratat e Punës dhe Kontratat e Binjakëzimit – gjatë një programi trajnimi 5-ditor janë trajnuar 25 nëpunës civilë të njësive IPA.

- Analiza e Impaktit Rregullator (RIA), Hartimi dhe Harmonizimi i legjislacionit – Program ku janë trajnuar anëtarët e GNP-së për kapitullin 1 Lëvizja e Lirë e Mallrave, për kapitullin 28, Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit dhe për kapitujt 3, 6, 20 dhe 30.
- Hartimi dhe përafrimi i legjislacionit – program trajnimi me pjesëmarrës anëtarët e GNP-së për kapitullin 20 dhe 30 dhe nëpunës të tjerë të administratës publike. Në këtë program janë trajnuar 35 nëpunës të administratës.
- Asistenca financiare e BE-së – program trajnimi për nëpunës civilë në pushtetin vendor. Në këtë program kanë marrë pjesë 156 punonjës të administratës vendore.

Gjatë vitit 2017 e në vazhdim, MIE do të asistohet gjithashtu nëpërmjet projektit të asistencë teknike të BE-së “Mbështetje për procesin e integritimit SMEI- IV” në vazhden e programeve të asistencës për fuqizimin e kapaciteteve institucionale në parapërgatitje për hapjen e negociatave.

10. Përfundime

Në përmbyllje të raportit të paraqitur nga Këshilli i Ministrave për Kuvendin e Shqipërisë mbi procesin e integritimit gjatë vitit 2016, vlen të theksohet se:

- Në vijim të miratimit të ndryshimeve kushtetuese dhe të ligjeve përkatëse, qeveria shqiptare do vazhdojë të ketë një fokus të veçantë zbatimin e Reformës në Drejtësi, në veçanti zbatimin e drejtë të ligjit të vetting-ut si kryekriter për çeljen e negociatave me BE-në;
- Në pararendje të çeljes së negociatave, ndërmarrjen e hapave për rritjen e kapaciteteve të administratës shqiptare, identifikimin e grupit negociator dhe e strukturës përkatëse sipas praktikave më të mira;
- Qeveria shqiptare do të vijojë të jetë e angazhuar për përmbushjen e pesë prioritetëve kyçe të përcaktuara në Udhërrëfyes. Gjithashtu, puna do të vazhdojë me intensitet të shtuar për të përmbushur të gjithë hapat e nevojshëm në zbatim të të gjitha rekomandimeve të evidentuara në Raportin e Komisionit Evropian për 2016;
- Në përmbushje të dokumentave ligjorë dhe strategjikë të parashikuar në PKIE 2017-2020, qeveria shqiptare do të angazhohet për miratimin e tyre në kohë dhe realizimin e plotë të PKIE-së;
- Vazhdimi i përpjekjeve për përfshirjen sa më të gjerë të të gjithë aktorëve në procesin e integritimit, me theks të veçantë tek roli i shoqërisë civile.
